



## LLUKAREVSKA NË TAKIM ME GRA SIPËRMARRËSE NË SH TIP

Drejtoresha e Drejtorisë së të Ardhurave Publike, Sanja Llukarevska, sot në Shtip u takua me gra sipërmarrëse nga regjioni lindor. Në takim, sipërmarrëset i ndanë përvojat dhe sfidat e tyre me të cilat përballen gjatë udhëheqjes së kompanive të cilat i udhëheqin.

E përbashkët e të gjitha menaxhueseve është angazhimi për zhvillim të suksesshëm të ekonomisë vendore dhe përkrahje në avansimin e gruas në bashkësinë e biznesit. Llukarevska, theksoi se Drejtoria e të Ardhurave Publike është institucion i hapur dhe gjitmonë e dëgjon zërin e obliguesve tatimorë, ndërsa me komunikim të drejtpërdrejt me ata, krijohen mundësi për gjetjen e vendimeve për tejkalimin e disa pengesave.

Drejtorja e të Ardhurave Publike duke përforsuar raportin me partneritet do të vazhdojë me mbajtjen e takimeve të tilla më qyetet tjera të vendit, dhe me atë e fillon shënimin e festës së nëpunësve tatimorë.

